



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Nr. 1554/Prot.

Tiranë, 04.5-2020

Lënda: Mbi Urdhërit nr.99 datë 26.03.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Drejtuar: Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë
Znj.Besa Shahini

E nderuar Zonja Ministre,

U njohëm me Urdhrin nr.104, datë 30.4.2020 të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë “*Për marrjen e masave për mbylljen e vitit akademik 2019-2020 nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia COVID-19*”.

Në mënyrë të menjëhershme, në zbatim të afateve të përcaktuara, ky Urdhër u përcoll zyrtarisht të gjitha njësitë kryesore dhe njësitë të tjera të UT, me qëllim hartimin e një plani masash, sipas kërkesave të pikës 2 të këtij Urdhëri.

Senati Akademik i UT, si organi më i lartë kolegjal në institucion, pasi do të analizojë me shumë kujdes informacionet dhe planin e masave nga çdo njësi e UT, do të shprehet zyrtarisht në lidhje me këtë çështje, sa të rëndësishme por edhe shumë delikate njëkohësisht, për arsye të situatës së pandemisë në të cilën gjendet vendi ynë, i shkaktuar nga virusi Covid 19.

Kjo vendimarrje e Senatit Akademik të UT, do të përcillet zyrtarisht edhe në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Por sigurisht, autoritetet drejtuese të Universitetit të Tiranës, brenda afateve të përcaktuara në këtë Urdhër, do të nxjerrin të gjitha aktet; do të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme dhe do të marrin të gjitha masat e duhura, për përmbylljen e vitit akademik 2019-2020, duke respektuar gjithashtu të gjitha protokollet e sigurisë për distancimin social të studentëve dhe stafit akademik.

Në lidhje me zbatimin e Urdhërit të sipërcituar dhe zbatimit të Urdhërit nr.99 datë 26.03.2020 “*Për disa ndryshime në urdhrin Nr.8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet*”



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, do të kërkoja vëmendjen Tuaj, për arsyet si më poshtë:

Së pari: në pikën 1 gërma “d” të Urdhrit nr.104 datë 30.04.2020, urdhërohet: “*krijimi i mundësive për kthimin në auditor të studentëve të viteve të para dhe të viteve të ndërmjetme të të gjitha cikleve të studimit, për përsëritjen e leksioneve, seminareve apo punëve laboratorike, pas datës 25 gusht të viti 2020, për një periudhë jo më pak se 4 javë*”.

Së dyti: mbështetur në Urdhrin nr.99, datë 26.3.2020 “*Për disa ndryshime në Urdhrin Nr.8, datë 14.01.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë”, fillimi i procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë është në datën 11.05.2020 dhe datat e zhvillimit të zgjedhjeve është data 12.06.2020.*

Në zbatim të nenit 5, pika 3 e Rregullores “*Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës*”, miratuar me Vendimin Nr.5, datë 10.02.2020 të Senatit Akademik UT, në cilësinë e Rektorit të UT, duhet të shpall ditën e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e përcaktuar në Urdhrin nr.99 datë 26.03.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për zgjedhjen e autoriteteve drejtuese dhe Senatin Akademik të Universitetit të Tiranës.

Gjithashtu, në nenin 22, pika 2 të Rregullores së sipërcituar theksohet se: “*kandidatët për Senatin Akademik, përfaqësues të studentëve, të cilët plotësojnë kriteret e....., propozohen nga jo më pak se 100 studentë, pjesë e trupës zgjedhore, të cilët mbështesin vetëm një kandidat. Në fletën që dëshmon për mbështetjen nga 100 studentë, duhet të jenë pasqyruar emri, mbiemri, mjeti i identifikimit si dhe fakultetit/dega nga vjen studenti*”.

Kjo pikë e Rregullores është në përputhje me nenin 37, pika 4 të ligjit 80/2015, “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”, i cili parashikon se: “*Në Senatin Akademik përfaqësohen edhe studentët në institucionet publike, në masën dhjetë për qind....*”

Në pikën 2 të nenit 39 të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, parashikohet se: “*Në institucionet publike të arsimit të lartë, rektori zgjidhet nga anëtarët e asambleve të personelit akademik të njësive kryesore dhe studentët. Votat e studentëve në përzgjedhjen e rektorit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave*”

Dhe në nenin 42, pika 3, të ligjit të arsimit të lartë 80/2015, për zgjedhjen e drejtuesit të njësisë kryesore (dekani), parashikohet: “*Votat e studentëve në përzgjedhjen e drejtuesit llogariten në masën dhjetë për qind të totalit të përgjithshëm të votave.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
REKTORI

Të gjitha sa më sipër, tregojnë qartë se studentët me kohë të plotë, janë një nga dy trupat zgjedhore që votojnë dhe përzgjedhin autoritetet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë.

Për më tepër, duke patur parasysh numrin e studentëve me kohë të plotë të vitit të parë dhe të viteve të ndërmjetme në të dyja ciklet e studimit në Universitetin e Tiranës, që është mbi 15.011 studentë nga 26.828 studentë me kohë të plotë në total që ka Universiteti i Tiranës, të cilët, sipas pikës 1, gërma d) të Urdhërit tuaj nr.104 datë 30.04.2020, mund të kthehen në auditore vetëm pas datës 25 gusht 2020, **parashikohet që mbi 15.000 studentë të mos marrin pjesë në votime dhe mos kenë të drejtë as të zgjedhin autoritetet drejtuese (rektor dhe dekan) dhe as të zgjidhen dhe të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UT.**

Por ligji i arsimit të lartë 80/2015, i ka dhënë atyre të drejtën për të zgjedhur dhe njëkohësisht edhe për tu zgjedhur, dhe me të drejtë, i ka caktuar si një nga dy trupat zgjedhore në procesin zgjedhor për të zgjedhur autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë.

Gjithashtu, mospjesëmarrja e studentëve në zgjedhje, çënon integritetin e procesit zgjedhor si dhe ligjshmërinë e tij.

Së treti: Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, më Urdhërin nr.260 datë 01.04.2020 "Për një ndryshim në Urdhërin nr.190 datë 19.03.2020 "Për ndërprerjen e veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe jobublike dhe çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit Covid 2019", ka urdhëruar mbylljen e institucioneve arsimore deri në përfundimin e gjendjes së epidemisë të shkaktuar nga infeksioni Covid 19.

Së katërti: Me Vendimin nr.342 datë 25.04.2020 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në Vendimin nr.243 datë 24.03.2020 të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore", gjendja e fatkeqësisë natyrore në vend është shtyrë deri në datën 23.06.2020.

Zonja Ministre,

Për të gjitha sa më sipër, do të kërkoja nga ana Juaj, në respektim të të gjitha akteve ligjore në fuqi të sipërcituara, rishikimin e Urdhërit nr.99 datë 26.03.2020, për shtyrjen e procesit zgjedhor dhe datës së zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në vend.

Duke ju falenderuar, shpreh bindjen në mirëkuptimin Tuaj,

